



Pranuar / Dorezuar Punëhëno/Prodato Received/Delivery	23.11.2022	2	viti god
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7361/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.904/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Eshref Shabani, anëtarë si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr.904/2022, të datës 13.10.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rruga, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.904/2022, e datës 13.10.2022, e parashtruar nga ankuesja.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën,, Asistente Administrative 3", me gradën dymbëdhjetë (12), me koeficientin pesë (5) në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me datë 13.10.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6144/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i behët ndryshimi i koeficientit nga koeficienti pesë (5), në koeficient gjashtë (6).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese tek Komuna e Mitrovicës. Ndërsa

me datë 16.11.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.904/2022 të datës 13.10.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomën e datës 30.06.2015 e lëshuar nga Kolegji Iliria; Përgjigje në kërkesë e datës 06.10.2022; Kërkesë e datës 30.09.2022, për harmonizim të koeficientit të pagës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 i datës 20.12.2019; Formulari për caktimin e objektivave për nëpunësin civil e datës 18.12.2019; Formulari për caktimin e objektivave për nëpunësin civil i datës 16.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 16.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 16.12.2020; Akt Emërimi i datës 24.10.2018; Përgjigje në ankesë e datës 16.11.2022, me numër protokoll 7164/2022 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës e datës 24.07.2018 dhe lista e pagave për muajin tetor 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pa bazuar sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesja [redacted] ka themeluar marrëdhënien e punës me Komunën e Mitrovicës, sipas Akt Emërimit të datës 24.10.2018, me numër protokoll 01-11/01-0082963/18, në pozitën „Asistente Administrative 3’’, me gradën dymbëdhjetë (12), me koeficientin pesë (5), në pajtim me nenin 23, paragrafi 1,2, nen paragrafi 2.5, të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e cila kishte qene në fuqi në këtë kohë, ku thuhet se: 1. Këto vende të punës ofrojnë mbështetje administrative dhe teknike në fushat përkatëse dhe janë përgjegjëse për pjesë të rëndësishme të punëve administrativo teknike të njësisë organizative. 2. Karakteristikat e nivelit administrativ tre (3) janë: 2.5. Kërkohet shkollimi i mesëm dhe trajnimet në fusha përkatëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës mori për bazë dispozitat e Rregullores aktuale (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku Kërkesat e Përgjithshme Formale për këtë pozitë janë: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka. c) Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet. Andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses sipas vlerësimit të kolegjit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në pretendimin ankimor, dhe bazuar në provat e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se përkundër që ankuesja ka pretenduar se ka zyrtar të njëjtë që kryejnë punë të njëjtë dhe se paguhen me koeficient gashtë (6) e që për këtë fakt ankuesja nuk ka sjell asnjë provë përkatësisht dëshmi, ndërsa Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë rëndësi të veçantë i ka kushtuar shkresës zyrtare të datës 06.10.2022 të lëshuar nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Mitrovicës me të cilin shkrese Menaxheri, ka konfirmuar se Komuna e Mitrovicës nuk ka ndonjë pozitë „Asistente Administrative 3’ ’ me koeficient



gjashtë (6) andaj edhe mbi bazë të kësaj rrethane Kolegji i këshillit konstaton se me asnjë provë konkrete nuk është provuar diskriminimi në këtë kuptim dhe se mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në Akt Emërimin e datës 24.10.2018, me numër protokolli 01-11/01-0082963/18, ka konstatuar se ankuesja mbanë pozitën „Asistente Administrative 3“, me gradën e punës dymbëdhjetë (12), koeficienti pesë (5), në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, citoj: *“Paga bazë e nëpunësit civil llogaritet duke shumëzuar koeficientin me vlerën e koeficientit”*, si dhe nenin 9 paragrafi 1 të ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës*, andaj mbi këto baza ligjore pretendimi ankimor është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.904/2022, me datë 23/11/2022

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.